



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**LIGJ**

**Nr. 36/2016**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 198, DATË 10.12.2009,  
“PËR SIPËRMARRJET E INVESTIMEVE KOLEKTIVE”<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 19, pas pikës 4 shtohen pikat 5 dhe 6 me këtë përmbajtje:

“5. Shoqëria administruese krijon një sistem gjithëpërfshirës dhe efektiv të administrimit të riskut, në përputhje me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarisë së saj të biznesit, i cili duhet të përmbajë, të paktën:

- a) strategjinë e administrimit të riskut, politikat, procedurat dhe masat;
- b) teknikat e matjes së riskut;
- c) ndarjen e përgjegjësive që kanë të bëjnë me administrimin e riskut.

6. Autoriteti miraton rregulla për administrimin e riskut, në përputhje me pikën 5, të këtij neni, 3 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.”.

**Neni 2**

---

<sup>1</sup> Ky ligj është përafuar pjesërisht me direktivën 2009/65/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 13 korrik 2009, “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative lidhur me sipërmarrjet për investimet kolektive në tituj të transferueshëm (UCITS)”, të ndryshuar. Numër CELEX 32009L0065, Fletore Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L 302, datë 17.11.2009, faqe 32 –96.

Në nenin 120 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“Pezullimi i shitjes dhe i shlyerjes së kuotave në një fond investimi”.

2. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Hiqen fjalët “nuk është i mundur të përcaktohet çmimi i saktë i asetëve në portofolin e fondit dhe se”.

b) Pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Për të njëjtat shkaqe, të parashikuara në këtë pikë, njëkohësisht me pezullimin e shlyerjes pezullohet, gjithashtu, edhe shitja e kuotave.”.

3. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Nëse shoqëria administruese merr vendim për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes së kuotave dhe, nëse depozitari nuk është dakord me një vendim të tillë, ky i fundit njofton menjëherë Autoritetin.”.

4. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Shoqëria administruese, në çdo rast, i njofton menjëherë AMF-së vendimin për pezullimin e shitjes dhe të shlyerjes së kuotave. AMF-ja, pas marrjes së njoftimit, mund të urdhërojë anulimin e këtij vendimi, nëse gjykon se është në interes të publikut ose në interes të investitorëve në fond. Shoqëria administruese publikon, menjëherë, në faqen e saj zyrtare të internetit, të dhënat për çdo pezullim të shitjes e të shlyerjes së kuotave, dhe përgjatë gjithë kohëzgjatjes së pezullimit, si edhe në një gazetë të përditshme, me qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.”.

5. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Shlyerja dhe shitja e kuotave në një fond investimi mund të pezullohet edhe nga AMF-ja, e cila mund të urdhërojë shoqërinë administruese dhe depozitarin të pezullojë përkohësisht shlyerjen dhe shitjen e tyre, nëse ekzistojnë shkaqe të forta dhe të justifikuara për këtë pezullim, si dhe nëse kjo është në interes të mbajtësve ekzistues të kuotave ose të mbajtësve potencialë.”.

6. Në pikën 4 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Në fillim të fjalisë së parë, fjalët “Pezullimi i shlyerjes” zëvendësohen me fjalët “Pezullimi i shitjes dhe i shlyerjes”.

b) Në fjalinë e parë, fraza “pasi shoqëria administruese dhe depozitari të kenë vendosur se është e mundur të përcaktohet çmimi i saktë i asetëve në portofolin e fondit” zëvendësohet me frazën “ose menjëherë sapo arsyet për pezullimin e shitjes dhe të shlyerjes nuk ekzistojnë më”.

c) Në fjalinë e dytë, pas fjalëve “fond investimi” shtohet fraza “i njoftohet pa vonesë AMF-së dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese, si dhe”.

7. Në pikën 6, fjalët “një rregullore” zëvendësohen me fjalët “rregulla më të hollësishme për pezullimin e shitjes dhe të shlyerjes së kuotave në fondet e investimeve, si dhe rregulla”.

### Neni 3

Në nenin 130, pika 1, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:

“ë) shoqëria administruese shkel rregullat për administrimin e riskut.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**Ilir META**

Miraturar në datën 31.3.2016